



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 - Nr. 08-322-20080/2014
Kaçanik, 18.07.2014

Në mbështetje të nenit 12.2 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 29.12(b) të Ligjit Nr. 03/L -153/2010-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3-Për Pyjet e Kosovës, nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse-dru për ngrohje, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 18.07.2014, mori këtë:

VENDIM

PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR, SHKOLLAVE TË KOMUNËS

I.

Me këtë Vendim, Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara në vitin 2014 që ndodhen në Autoparkun e Invalidëve të Luftës, atyre Shkollave të Komunës, të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë masën drusore.

II.

Pjesa e buxhetit e dedikuar për blerjen e sasisë drusore si në pikën I. të këtij Vendimi do të derdhet në fondin e DBZHRP, në sektorin e Pylltarisë me destinim për; mbrojtjen dhe kultivimin e pyjeve.

III.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset; drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drjtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
3. Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës,
4. Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim. dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i kuvendit,
Xhelal Gashi